



RAPORT AUDITIMI (TEMATIK)

BASHKIA ROSKOVEC

(Auditim Financiar, pasqyrat financiare 2021)

Tiranë, 2022

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITULJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 12
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimité é é é é é é é é é é é é é é é é é	4 – 5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveé é é é é é é é é é é é é é é é é é	5 – 10
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimité é é é é é é é é é é é é .	10 - 12
II	HYRJA	12 – 16
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i> b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i> c. <i>Identifikim i çështjes.....</i> d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i> e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i> f. <i>Kriteret e vlerësimit</i> g. <i>Standardet e auditimit.....</i> h. <i>Metodat e auditimi</i> i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16 - 26
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	16 – 17
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	17 – 26
2.1	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 202</i>	<i>17 – 26</i>
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIME	26 – 30
V.	ANEKSE	30 - 34

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve.
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 13.6.2022 deri në datë 23.6.2022, realizoi auditimin financiar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Roskovec, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në hartimin e pasqyrave financiare viti 2021.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krah

as njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Roskovec për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një ***opinion të kundërt***, për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021).

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Roskovec si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me nëBartës Informatikë, të cilët janë programe informatike të	<i>I lartë</i>	<i>17-26</i>	Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njërive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. <i>Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11.</i>			
2	Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2021 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2021 konkretisht; 1. Llog.(210) Ën Toka, troje, terrene Ën nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe truallit përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 Ën <i>Ndërtime e konstruksione</i>. b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhet bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec nuk janë reflektuar saktë ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19 të datës 16.01.2019, në të cilin detyrohet si Njësi të cilës i kalon prona me vlerë 30,755,412 lekë, pasi kjo vlerë nuk është e ndarë se sa është ndërtesë dhe sa truall. Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk rezultojnë të jetë pasqyruar VKM 29.09.2021, për Sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë	I lartë	17-26	Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që; a-Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë. b-Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 <i>"Ndërtesa Konstruksione"</i> për NjA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik. Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	<i>gjashtëdhjetë e tre) lekësh; e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.</i> 2. Llog.(211) <i>“Pyje, Kullota, Plantacione”</i> nuk paraqet gjendjen reale sepse edhe pse ka reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse 208,21 Hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 <i>“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar pika 24, shtojca me nr.22, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, nuk ka kryer inventar për gjendjen fizike të këtyre aktiveve, për të cilën auditimi nuk mund të shprehet me siguri.</i> 3. Llog.(212) <i>“Ndërtim e Konstruksione”</i> nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m² të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objekteve të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunitat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të <i>“Ndërtesave e Konstruksioneve”</i> nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Gjithashtu godina në të cilën ushtron aktivitetin e saj Administrata e Bashkisë Roskovec, është financuar nga Buxheti i Shtetit dhe vlera e investimit me objekt <i>“Projekti Zhvillimor i Bllokut nr.2, Roskovec”, sipas kontratës së lidhur është në shumën 232,483,780 lekë me TVSh. Nga titullari i Bashkisë Roskovec, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike rezulton të jetë regjistruar në llogarinë përkatëse ndërtesa e Bashkisë së Re, por nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre. Gjithashtu për vlerën e raportuar si shtesë gjatë vitit, nuk është llogaritur amortizimi i cili duhet të llogaritet nga momenti i marrjes në dorëzim të aktivitetit dhe vënies në shfrytëzim të tij. Për sa më sipër Llog. 212 “Ndërtim e konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të</i>			llogarive përkatëse në PF.

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	vitit 2021. 4. Llog.(213) <i>Ërrugë, rrjete, vepra ujore</i> nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, <i>ËPër</i> disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, <i>Ëpër</i> vënien në dispozicion të shoqërisë trans A....., nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans A...., <i>Ëpër</i> ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, për kalimin <i>e38 metra lineare, në total 14,457 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 m2 pa kompensim; si dhe sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra linear, në total 5,755 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1,304 m2.</i> 5.Llog.(520) (Disponibilitete në thesar) nuk paraqet një pamje reale pasi; në pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 rezulton në shumën 106,831,971 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 75,433,269 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 (<i>kreditorë në ruajtje</i>) e cila paraqitet në shumën 57,303,684 dhe llog. 85 (<i>teprica e periudhës</i>) e cila paraqitet në shumën 18,129,585 lekë. Në ekstraktin e rakordimit të paraqitur nga sistemi i Thesarit llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit. <i>Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligji nr.68/2017"Përfinancat qeverisjesvendore", neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika (1); (2), VKM Nr 433 dt 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, 50, Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101.</i>			

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
3	Nga analizimi i llogarisë 486(shpenzime të periudhave të ardhshme) rezulton se; kjo llogari paraqitet në shumën 289,946,932 lekë në fund të vitit 2020. Për periudhën 2021 nga ana e Bashkinë Roskovec janë bërë përpjekje për uljen e detyrimeve ku detyrimet e lindura gjatë vitit 2021 paraqiten në shumën 72,398,933 lekë si dhe shlyerjet paraqiten në shumën 192,829,153 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc në llogarinë 486 përputhet me shumën e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me Degën e Thesarit për vitin 2021. Referuar dokumentacionit të audituar, që disponon Bashkia, lidhur me likuidimin e detyrimeve për vitin 2021 rezulton se, shuma e detyrime të prapambetura më datë 31.12.2021 është 169,731,367 lekë. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe garantimin e pagesave në kohë. Në rastet e mos likuidimit në kohë nuk rezulton asnjë analizë apo shpjegim ndaj nëpunësit autorizues, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. Nga kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit, rezulton se gjatë vitit 2021 janë likujduar 13 raste në shumën 47,969,662 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2018, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2021 për tu likujduar. Janë likujduar 33 raste në shumën 77,035,471 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2019, ndërkohë që janë regjistruar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021 dhe 54 raste në shumën 53,179,933 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2020, ndërkohë që janë regjistruar për tu paguar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021. Gjithashtu referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezulton të ketë fatura të vitit 2021 të cilat janë regjistruar dhe likujduar në sistem në vitin 2022, fatura të cilat i përkasin shpenzimeve apo detyrimeve të vitit 2021 në shumën 7,581,104 lekë. Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse	I lartë	17-26	Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë. Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për paraqitjen në kohë me besueshmëri të shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare me qëllim, raportim të drejtë të situatës financiare të Njesisë.

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 nëPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 61, nenin 54, nëKryerja e pagesave, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15 pika 1, nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 nëPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 nëPër procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, pikën 164.			
4	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2021 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajtje kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.	I lartë	17-26	Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.
5	Për vitin 2021 në lidhje me zërin (Tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë	I lartë	17-26	Nga Bashkia Roskovec, Drejtorja Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
	se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, kreu IV, pika 74.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Roskovec, pavarësisht punës dhe përpjekjeve të mira menaxhuese, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një **opinion të kundërt**. Fushat kryesore në të cilat janë konstatuar gabime, janë në pasqyrimin jo të saktë të disa llogarive në pasqyrat financiare.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i pasqyrave financiare viti 2021:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Roskovec për periudhën ushtrimore 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dheshënime dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **Opinion të Kundërt**¹ për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Roskovec, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërpjethshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021”, të shprehura në bazën për opinion.*

Baza për opinionin:

¹ **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërpjethshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale, të përhapura**, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të viteve objekt auditimi, nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, përgjegjësi kjo e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive.

1. Llog.(210) *“Toka, troje, terreneò*, nuk paraqet gjendjen reale pasi nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të godinës së re të Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llog. 212 *“Ndërtim e konstruksioneò*. Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse, pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar përsipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh; e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.

2. Llog.(211) *“Pyje, Kullota, Plantacione”*, nuk paraqet gjendjen reale sepse edhe pse ka reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse 208, p r 21 hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM nr. 433 dt 08.06.2016 *“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveò*, e ndryshuar pika 24, shtojca me nr.22, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, **nuk ka kryer inventar për gjendjen fizike të këtyre aktiveve, për të cilën auditimi nuk mund të shprehet me siguri.**

3. Llog.(212) *“Ndërtim e Konstruksioneò*, nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m² të trashëguara nga ish Komunitat të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të *“Ndërtesave e Konstruksioneveò* nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave. Gjithashtu godina në të cilën ushtron aktivitetin e saj Administrata e Bashkisë Roskovec nuk është llogaritur amortizimi nga momenti i marrjes në dorëzim të aktivitetit dhe vënies në shfrytëzim të tij. Për sa më sipër Llog. 212 *“Ndërtim e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2021.

4. Llog.(213) *“Rrugë, rrjete, vepra ujoreò* nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, *“Përdisa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, në lidhje me projektin e gazsjellësit trans Adriatik (projekti TAP).*

5. Llog.(520) *“Disponibilitete në thesarò*, nuk paraqet një pamje reale pasi; në pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 rezulton në shumën 106,831,971 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 75,433,269 lekë, ndërkohë që në ekstraktin e rakordimit të paraqitur nga sistemi i Thesarit llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit.

-Gjatë vitit 2021 janë likuiduar 13 raste në shumën 47,969,662 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2018, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2021 për tu likuiduar. Janë likuiduar 33 raste në shumën 77,035,471 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2019, ndërkohë që janë regjistruar si fatura për tu likuiduar gjatë vitit 2021 dhe 54 raste në shumën 53,179,933 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2020, ndërkohë që janë regjistruar për tu paguar si fatura për tu likuiduar gjatë vitit 2021. Nga sistemi SIFQ rezulton të ketë fatura të vitit 2021 të cilat janë regjistruar dhe likuiduar në sistem në vitin 2022, fatura të cilat i përkasin shpenzimeve apo detyrimeve të vitit 2021 në shumën 7,581,104 lekë.

-Nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi.

- Nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Roskovec, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurtisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbyllur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Projektit dhe Programit Tematik të Auditimit nr. 568, datë 14.6.2021 dhe Autorizimit nr. 568/1, datë 8.6.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 13.6.2022 deri në datën 23.6.2022, në subjektin Bashkia Roskovec u krye auditimi në *Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2021*, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ.** (Përgjegjës grupi).

2. **E.M.** (Anëtarë)

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Roskovec.

a- Objekti i auditimit, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2021 i 31.12.2021, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

b- Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)².

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

c- Identifikimi i çështjes: Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Roskovec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Roskovec, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

e- Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të shpenzimeve operative dhe investimeve, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

f- Kriteret e vlerësimit.

✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

²Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*.
- ✓ Rregullore e Brendshme *ñMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.
- ✓ Rregullore e Brendshme *ñMbi Procedurat e auditimit në KLSH*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020.
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar.
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Manualët e Auditimit Financiar të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ñPër financat e vetëqeverisjes Vendore*.
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 *ñPër procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, *ñPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006*.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.2.2022 *ò Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*.

g- Standardet e auditimit:

- ✓ ISSAI 100 *ñParimet themelore të auditimit të sektorit publik*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ✓ ISSAI 2000-2899 *ñUdhëzues të Auditimit Financiar*.
- ✓ ISSAI 2300 *ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*.
- ✓ INTOSAI GOV 9100 *ñUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*.
- ✓ INTOSAI GOV 9110 *ñUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme*.
- ✓ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

h- Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 *ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese

përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

i-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

j- Dokumentimi i auditimit:

³Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Auditimi në Bashkinë Roskovec u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në hartimin e pasqyrave financiare, *materiale dhe të përhapura*, duke konkluduar në një **opinion të kundërt**. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime për çdo problematik të konstatuar, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Roskovec deri me datë 23.6.2022, datën e mbylljes së punës audituese në terren.

Nga subjekti Bashkia Roskovec nuk janë paraqitur kundërshti sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Auditimit të KLSH mbi problemet e konstatuara nga grupi i auditimit dhe të reflektuara në akt-konstatimeve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Roskovec është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 në Për Vetëqeverisjen Vendore dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 në Për financat e vetëqeverisjes Vendore, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Roskovec.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1 e programit. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

Njësia ekonomike raportuese (*Bashkia Roskovec*) ka përgatitur e raportuar Pasqyrat Financiare të periudhës ushtrimore 2021 mbështetur Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (UMFE) nr. 8, datë 09.03.2018 në *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*. Në përgatitjen, hartimin dhe ndërtimin e pasqyrave financiare të konsoliduar të periudhës raportuese ushtrimore 2021, janë përfshirë edhe entitetet si; Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje e Varrezave, Ndërmarrja Shërbimeve të Mirëmbajtjes në varësi e pronësi të njësisë ekonomike raportuese (*Bashkia Roskovec*), që kanë përgatitur pasqyra financiare si njësi ekonomike raportuese të pa varura. Pasqyrat financiare nga ana formale janë përgatitur e plotësuar sipas kërkesave të UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 në të cilat është dhënë informacion mbi:

- Emri Njësies ekonomike raportuese vendore, Bashkia Roskovec me NIPT K52905407N;
- Periudha kontabël e mbuluar nga pasqyrat financiare (01.01.2021-31.12.2021);
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare 31.03.2022;
- Përgatitur nga S.Ç., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe nënshkruar nga M.B. në cilësinë e nëpunësit autorizues;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit me shkresën nr.2693, datë 01.04.2022, nënshkruar nga titullari i Njësies dhe nëpunësi zbatues, një ditë me vonesë, ndërkohë që elektronikisht janë përcjellë me datë 31.03.2021
- Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimi financiar janë rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit datë 27.01.2021 të konfirmuara dhe nënshkruar nga NZ, nga NA Bashkia Roskovec dhe Përgjegjësi Degës së Thesarit Fier.

Nëpunësi Zbatues është emëruar nga Titullari i Bashkia Roskovec me shkresën nr.623prot, datë 27.08.2015, S.Ç., dhe me shkresën nr. 12357/1prot, datë 03.08.2015, është përcjellë për njohje Degës së Thesarit Fier, për njohjen e firmës mbi transaksionet e pagesave në vijim.

Pjesë përbërëse e PF/2021 janë:

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

Dokumentacioni kontabël i veprimtarisë financiare, klasifikimi, përpunimi, ruajtja dhe mbajtja e kontabilitetit kryhet nëpërmjet programit Excel. Nëpërmjet këtij formati Bashkia Roskovec, Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje e Varrezave, Ndërmarrja Shërbimeve të Mirëmbajtjes si njësi shpenzuese në varësi të Bashkisë, mbajnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat kontabël po në të njëjtin format pra në mënyrë manuale, duke paraqitur mosbesueshmëri dhe risk për përmbytjen e tyre.

Titulli i gjetjes 1: *Mos mbajtja e regjistrimeve kontabël me bartës informatik.*

Situata:

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Roskovec, mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lart

për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi eksel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njesisë dhe njësive të vartësisë. Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me ñBartës Informatikò, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

Kriteri:

Ligji nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;

“Dokument kontabël” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë...

“Bartës Informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.”

me nenin 11 ku citohet se;

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ndikimi/Efekti:

Paraqitje e riskut për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar në vendimmarrjen e drejtimit të Bashkisë Roskovec.

Shkak: Mosnjohja e legjislacionit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2021, paraqitet në Aneksin nr. 1. Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020 dhe të vitit 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivit, si në vijim.

Titulli i gjetjes 2: Paraqitje jo e saktë midis të dhënave të rakorduara me thesarin dhe PF.

Situata:

Llogaria 520 (Disponibilitete në thesar) paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 në shumën 106,831,971 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 75,433,269 lekë, shumë e cila ka kundërpasigje llog. 466 (kreditore në ruajtje) në shumën 57,303,684 dhe llog. 85 (teprica e periudhës) në shumën 18,129,585 lekë. Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet

me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordimi të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit.

Kriteri:

UMF nr. 5, datë 21.2.2022 në *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap. III, pikat 30, 50

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i saktë në thesar të aktiveve monetare.

Shkaku: Neglizhencë dhe rakordim jo i drejtë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Drejtori i Financës të marrë masat e duhura që, të verifikojë të dhënat e aktiveve monetare në Thesar dhe të raportojë saktë gjendjen dhe situatën financiare të Bashkisë Roskovec.

Titulli i gjetjes 3: *Mos pasqyrim i saktë i gjendjes reale të llogarive 210-211-212-2013 në Pasqyrat Financiare.*

Situata:

Nga verifikimi i disa llogarive të klasës 2 rezultoi se; Llog 210 “*Toka, troje terrene*” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 njësitë administrative, në fund të 2020 rezulton në vlerën 112,776,000 lekë, në 2021 rezulton po në vlerën 112,776,000 lekë pra nuk ka as shtesa e as pakësime në këtë llogari, konkretisht si më poshtë;

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 31.12.2020 (D)	112,776,000
Gjendja në 01.01.2021	112,776,000
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Hapësira rekreative për fëmijët	0
Pakësim gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	112,776,000

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Regjistrimit të Pronave (SRP) të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë Ekonomike për truallin nën objekt të objekteve të administruara në llog.(210) në Toka, troje terrene u konstatua se; Bashkia Roskovec, sipas DRP ka në administrim gjithsej 38 objekte ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe trualli nën këto objekte prej 74,995 m², nga të cilat dokument të pronësisë (çertifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për 8 objekte me sipërfaqe trualli nën këto objekt të objekteve prej 28,703 m², kurse për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m² nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto, Drejtoria Ekonomike ka të administruara në kontabilitet zero m² të truallit nën objekt të objekteve. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo truall të “*Toka, troje, terrene*” nga Bashkia Roskovec duhet që patjetër të kryejë sistemimin e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 në *Ndërttime e konstruksione*, vlera e trojeve të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, vlera e truallit dhe ndërtesave të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Fier si dhe inventarizimi i trojeve me komision përkatës. Në këtë llogari nuk është pasqyruar VKM datë 29.09.2021, në Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, nëpër vënien në dispozicion të shoqërisë trans A..., nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të

ndërtimit dhe korridorit i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans Adriatik (projekti TAP)ò, për ndryshimet përkatëse në llogarinë 210, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht: -Sipërfaqja tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh; vlerë e cila duhet të pasqyrohet në PF.

Më poshtë po paraqesim tabelën e detajuar:

Nr	Emërtimi	Gjithsej		Të pa Regjistruara		Të Regjistruara	
		Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli	Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli	Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli
I	Bashkia Roskovec	10	18,337	8	9,565	2	8,768
II	Njësitë administrative	28	56,658	22	13,738	6	19,935
1	Njësia Administrative Strum	8	26,224	8	3,239	-	-
2	Njësia Administrative Kuman	8	24,024	6	5,749	2	18,275
3	Njësia Administrative Kurjan	12	6,410	8	4,750	4	1,660
	Shuma gjithsej	38	74,995	30	23,303	8	28,703

Nga auditimi mbi saktësinë e Llog 210 në Toka, troje terreneò rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2021.

Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 njësitë administrative në fund të 2020 paraqitet në vlerën 192,000 lekë, ndërsa në vitin 2021 paraqitet në vlerën 264,656,900 Shtesa prej 264,464,900 lekë i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave me VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 në *Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveò, pika 24, shtojca me nr.22, e ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, pika 1, germa gj) e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, me numrin rendor 1 (një) deri 24 (njëzetë e katër). Lista përkatëse rezulton të jetë në 208,21 Hektarë të cilat edhe pse janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Roskovec të vitit 2021 për këto aktive nuk ka dokumentacion pronësor.*

Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 njësitë administrative, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 454,268,780 lekë dhe fund të vitit 2021 për vlerën 843,273,458 lekë ose me rritjen në vlerën neto 389,005,678 lekë dhe është pakësuar amortizimi vjetor në shumën 22,713,389 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 31.12.2020 (D)	454,267,780
Gjendja në 01.01.2021	454,267,780
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	411,719,067
Pakësim gjatë vitit 2021 (K)	0
Pakësim amortizim i akumuluar	- 22,713,389
Gjendja në 31.12.2021 (D)	843,273,458

Burimi: Të dhëna të marra nga Pasqyrat financiare

Referuar të dhënave në këtë llogari rezulton se nuk paraqet situatën reale pasi, amortizimi i akumuluar është llogaritur vetëm për vlerën e çeljes së aktiveve gjatë këtij viti, pra për shumën 454,297,780 lekë dhe amortizimi në shumën 22,713,389 lekë ndërkohë që, për vlerën e shtuar prej 411,719,067 lekë, nuk është llogaritur amortizimi përkatës, edhe pse regjistrimi është bërë në vitin 2021, llogaritja e këtyre aktiveve duhet të bëhet nga momenti i marrjes në dorëzim.

-Llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 914,058,865 lekë, ndërsa në vitin 2021 gjendja paraqitet në vlerën 1,645,073,183 lekë. Kjo rritje vjen si rezultat i disa investimeve të bëra gjatë vitit ushtrimor dhe viteve përpara periudhës raportuese në rrugët e qytetit, fshatrave, etj, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë përfunduar gjatë vitit ushtrimor, konkretisht të dhënat dhe lëvizjet jepen si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 31.12.2020 (D)	1,545,431,903
Gjendja në 01.01.2021 kosto historike	914,058,865
Amortizim i akumuluar	631,373,038
Vlera Neto	913,694,865
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	913,826,091
Marrja në dorëzim e objekteve të përfunduara gjatë vitit 2021	913,826,091
Amortizim gjatë vitit	182,811,773
Amortizim i akumuluar në fund të vitit	814,184,811
Gjendja në 31.12.2021 (D)	2,459,257,994
Vlera neto	1,645,073,183

Referuar pasqyrës 7/a në këtë llogari gjatë vitit 2021 me ndryshime.

Nga verifikimet e bëra rezulton se; në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk është pasqyruar VKM datë 29.09.2021, nëPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, nëpër vënien në dispozicion të shoqërisë trans A....., nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans A....., për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht për:

-sipërfaqen ujore kanal në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra, në total 14 457 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2 838 pa kompensim;

- sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra, në total 5 755 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 1 304 m2 pa kompensim.

Kriteri:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu (VI) “*Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pika 1 dhe 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave me datë 29.09.2021, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2021 në llog. (210-211-212-213); nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2021.

Shkaku:

Nga Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave nuk janë marrë masat e duhura për reflektimin e VKM-ve për këto llogari, regjistrimin e investimeve, analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar të dala dhe të trashëguara nga ish-Komunat.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM

në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në PF.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që;

1.Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

2.Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212“*Ndërtesa Konstruksione*” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Titulli i gjetjes 4:*Mungesë e regjistrimit kontabël të aktiveve dhe përditësimit të tij.*

Situata:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2021 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike në cilësinë e nëpunësi zbatues, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitet në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Kriteri:

Ligji nr. 25/2018, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pikat 26-33.

Ndikimi/Efekti:

Risk i mundshëm për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Shkaku: Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi:

Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Titulli i gjetjes 5:*Kritje e detyrimeve dhe mos marrje masash për likuidimin në kohë të tyre.*

Situata:

Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në vitin 2020 paraqitet në shumën 142,325,599 lekë, ndërsa për vitin 2021 në

shumën prej 172,057,183 lekë. Gjatë vitit 2021 shtesa prej 29,731,584 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Roskovec dhe Njësive vartëse. Gjithashtu janë likujduar gjatë vitit 2021 debitorë të viteve të mëparshme për shumën 49,869,267 lekë. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitoare dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

-*Llogaritë 401-408 në Furnitorë e llogari të lidhura me to* në fillim të vitit 2021 rezulton për vlerën 7,125,799 lekë dhe në fund të vitit 2021 është në vlerën 762,867 lekë ose me ulje në vlerën (6,362,12) lekë.

- *Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"*

Bashkia Roskovec ka detyrime të prapambetura të mbartura në vite, të evidentuara në Llogarinë 486 në shumën 289,946,932 lekë në fund të vitit 2020. Këto detyrime janë të ardhura si detyrime nga ish Komunat, tashmë pjesë e Bashkisë Roskovec si dhe detyrime të mbartura ndër vite. Për periudhën 2021 nga ana e Bashkinë Roskovec janë bërë përpjekje për uljen e detyrimeve ku detyrimet e lindura gjatë vitit 2021 paraqiten në shumën 72,398,933 lekë si dhe shlyerjet paraqiten në shumën 192,829,153 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc në llogarinë 486 përputhet me shumën e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me Degën e Thesarit për vitin 2021. Referuar dokumentacionit të audituar, që disponon Bashkia, lidhur me likuidimin e detyrimeve për vitin 2021 rezulton se, shuma e detyrime të prapambetura më datë 31.12.2021 është 169,731,367 lekë për Bashkinë Roskovec. Në lidhje me detyrimet ndaj furnitorëve rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për garantimin e pagesave në kohë dhe në rastet e mos likuidimit në kohë nuk rezulton asnjë analizë apo shpjegim ndaj nëpunësit autorizues.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 në Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.

Ndikimi/Efekti:

Mundësi për mos arkëtimin e debitorëve duke kaluar afatet administrative, si dhe rritje të detyrimeve si rezultat i mos likuidimit në kohë të furnitorëve.

Shkaku: Mosrespektim dhe mos zbatim i kuadrit ligjor për debitorët dhe kreditorët.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi:

Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

Titulli i gjetjes 6: Fatura shpenzimesh të regjistruara jo në kohën e duhur.

Situata:

Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit, rezulton se gjatë vitit 2021 janë likujduar 13 raste në shumën 47,969,662 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2018, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2021 për tu likujduar. Janë likujduar 33 raste në shumën 77,035,471 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2019, ndërkohë që janë regjistruar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021 dhe 54 raste në shumën 53,179,933 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2020, ndërkohë që janë regjistruar për tu paguar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021. Gjithashtu referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezulton të ketë fatura të vitit 2021 të cilat janë regjistruar dhe likujduar në sistem

në vitin 2022, fatura të cilat i përkasin shpenzimeve apo detyrimeve të vitit 2021 të cilat paraqiten në shumën 7,581,104. Këto veprime janë jo në përputhje me parimet, udhëzimet dhe rregullat kontabël për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, dhe sistemin buxhetor për të cilat auditimi gjykon se kanë ndikuar në mosparaqitjen e vërtetë dhe të sinqertë, të saktë dhe të besueshme të pasqyrave financiare për shpenzimet e kryera për vitet paraardhëse duke rritur detyrimet në këtë mënyrë në vitet pasardhëse pasi, regjistrimi i transaksioneve/veprimeve është bërë kur janë paguar dhe jo kur ato kanë ndodhur si ngjarje pra duke vepruar mbi baza cash në lidhje me këto shpenzime dhe jo mbi parimin e të drejtave dhe detyrimit të konstatuar. Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Kriteri:

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”.

- Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1 dhe nenin 11 pika 1.

- Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) .

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164 .

Ndikimi/Efekti: Raportim jo i saktë në vlerë dhe në kohë i detyrimeve dhe shpenzimeve.

Shkaku: Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi:

Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për paraqitjen në kohë me besueshmëri të shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare me qëllim, raportim të drejtë të situatës financiare të Njesisë.

Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601).

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave, raportet e përkohshëm, lejet e zakonshme e deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në disa nga listë pagesat e muajve, janar, maj, dhjetor të vitit 2021 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejt sipas tabelës së pagave. Gjithashtu liste pagesat janë të shoqëruara dhe me liste prezencat përkatëse. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe nëpunësi i autorizuar i Bashkisë.

-Për të gjithë periudhën e audituar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhur, si dhe janë bërë sipas kohëzgjatjes orare të punës.

Më poshtë të dhënat e llog. 600-601;

Llogaria	E M E R T I M I	Viti 2021	Viti 202
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	106.303.481	97.515.121
6001	Paga, personel I përhershëm	103.654.671	97.074.662

Llogaria	E M E R T I M I	Viti 2021	Viti 202
6002	Paga personel I Përkohshëm	0	
6003	Shpërblime	2.648.810	440.459
6009	Shpenzime të tjera për personelin		
601	IL KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	17.112.507	16.073.590
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	15.350.862	14.428.247
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	1.761.645	1.645.343

Burimi i të dhënave: Sipas pasqyrave të Bashkisë Roskovec

-Inventari Fizik

Në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, pika (1), neni (15) në Inventari aktiveve e detyrimeve; UMF nr.30, datë 27.12.2011 në Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Kreu (IV) në Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve pika (81) në njësinë publike vendore Bashkia Roskovec u verifikuan procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; në aktive afat shkurtër; në gjendje inventar qarkullues; në materiale; në inventar i imët; në aktive afatgjatë jo materiale dhe në aktive afatgjatë materiale për vitin 2021. Komisionet e inventarizimit në fillim të procesit kanë në dispozicion listën e aktiveve për tu inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabël të njësisë publike vendore.*

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese 2021 u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të aktiveve afatgjatë dhe afatshkurtra (materiale e jo materiale) dhe në inventar qarkullues të pasurisë, asetëve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Roskovec, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 129, administruar me shkresën nr. 7783, datë 17.11.2021, *“Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2021”, me komisionet përkatëse. Komisionet do të bëjnë verifikimin e ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe të kapitaleve të veta të institucionit, Njësitë Administrative Kuman, Krujan dhe Strum, kopshtet, shkollat, pallati i kulturës si dhe Qendra Rinore, për vitin 2021.*

Janë printuar kartelat me aktivet për secilin punonjës të Bashkia Roskovec, nga Drejtoria ekonomike të cilat pasi është kryer verifikimi janë nënshkruar nga komisioni dhe punonjësi me përgjegjësi materiale. Nga verifikimi me zgjedhje nuk rezultojnë problematika për kryerjen e procesit të inventarizimit si për Bashkinë ashtu edhe për njësitë e varësisë. Përveç sa përmendet sa më sipër rezultoi se;

Titulli i gjetjes 7: *Nuk është kryer verifikim fizik për zërat e bilancit në llog. 210-211,212,213,215,202 mos paraqitje e dokumentuar e vlerave të tyre në Pasqyrat Financiare të Bashkia Roskovec.*

Situata:

Nga verifikimi i procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2021 në lidhje me zërin e llog.210 (Toka, troje, terrene) e cila paraqitet në shumën 112,776,000 lekë, në llog.211(pyje, kullota, plantacione) e cila paraqitet në shumën 264,656,900 lekë, në llog.212(ndërtime e konstruksione) e cila paraqitet në shumën 843,273,458 lekë, në llog.213(rrugë, rrjete, vepra ujore) e cila paraqitet në shumën 1,645,073,183 lekë, në llog. 215(mjete transporti) e cila paraqitet në shumën 5,582,101 lekë si dhe llog.202(studime e kërkime) e cila paraqitet në shumën 12,786,588 lekë, të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia

Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit.

Kriteri:

Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, kreu IV, pika 74, ku ndër të tjera citohet se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Ndikimi/Efekti:

Paraqitje jo e saktë dhe e dokumentuar e zërit troje, pyje, kullota, ndërtime, rrugë, rrjete, etj., sipas vlerave në pasqyrat financiare, premisa për humbje të aktiveve në këto zëra.

Shkaku: Mungesa ose neglizhenca e kontrollit dhe verifikimit të aktiveve të shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIMIE

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Roskovec si dhe në Njësitë vartëse, rezultoi se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me nëBartës Informatikë, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. *Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësisë Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Brenda datës 31.12.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2021 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2021 konkretisht;

1. Llog.(210) *ñToka, troje, terreneò* nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 *ñNdërttime e konstruksioneò*.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec nuk janë reflektuar saktë ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19 të datës 16.01.2019, në të cilin detyrohet si Njësi të cilës i kalon prona me vlerë 30,755,412 lekë, pasi kjo vlerë nuk është e ndarë se sa është ndërtesë dhe sa truall.

Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar VKM 29.09.2021, **për Sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh; e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.**

2. Llog.(211) *“Pyje, Kullota, Plantacione”* nuk paraqet gjendjen reale sepse edhe pse ka reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse 208,21 Hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 *ñPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveò*, e ndryshuar pika 24, shtojca me nr.22, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, nuk ka kryer inventar për gjendjen fizike të këtyre aktiveve, për të cilën auditimi nuk mund të shprehet me siguri.

3. Llog.(212) *ñNdërttime e Konstruksioneò* nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m² të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunitat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të *ñNdërtesave e Konstruksioneveò* nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Gjithashtu godina në të cilën ushtron aktivitetin e saj Administrata e Bashkisë Roskovec, është financuar nga Buxheti i Shtetit dhe vlera e investimit me objekt *ñProjekti Zhvillimor i Bllokut nr.2, Roskovecò*, sipas kontratës së lidhur është në shumën 232,483,780 lekë me TVSh. Nga titullari i Bashkisë Roskovec, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike rezulton të jetë regjistruar në llogarinë përkatëse ndërtesa e Bashkisë së Re, por nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre. Gjithashtu për vlerën e raportuar si shtesë gjatë vitit, nuk është llogaritur amortizimi i cili duhet të llogaritet nga momenti i marrjes në dorëzim të aktivitetit dhe vënies në shfrytëzim të tij. Për sa më sipër *Llog. 212 “Ndërttime e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2021.

4. Llog.(213) *Ërrugë, rrjete, vepra ujore* nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, nëPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, nëpër vënien në dispozicion të shoqërisë trans A....., nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans A....., për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, për kalimin e 38 metra lineare, në total 14,457 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 m2 pa kompensim; si dhe sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra linear, në total 5,755 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1,304 m2.

5.Llog.(520) (Disponibilitete në thesar) nuk paraqet një pamje reale pasi; në pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 rezulton në shumën 106,831,971 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 75,433,269 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 (kreditorë në ruajtje) e cila paraqitet në shumën 57,303,684 dhe llog. 85 (teprica e periudhës) e cila paraqitet në shumën 18,129,585 lekë. Në ekstraktin e rakordimit të paraqitur nga sistemi i Thesarit llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligji nr.68/2017"Përfinancat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika (1); (2), VKM Nr 433 dt 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, 50, Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në PF.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që;

1.Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

2.Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 "Ndërtesa Konstrukione" për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 486(shpenzime të periudhave të ardhshme) rezulton se; kjo llogari paraqitet në shumën 289,946,932 lekë në fund të vitit 2020. Për periudhën 2021 nga ana e Bashkinë Roskovec janë bërë përpjekje për uljen e detyrimeve ku

detyrimet e lindura gjatë vitit 2021 paraqiten në shumën 72,398,933 lekë si dhe shlyerjet paraqiten në shumën 192,829,153 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc në llogarinë 486 përputhet me shumën e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me Degën e Thesarit për vitin 2021. Referuar dokumentacionit të audituar, që disponon Bashkia, lidhur me likuidimin e detyrimeve për vitin 2021 rezulton se, shuma e detyrime të prapambetura më datë 31.12.2021 është 169,731,367 lekë. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitoare dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe garantimin e pagesave në kohë. Në rastet e mos likuidimit në kohë nuk rezulton asnjë analizë apo shpjegim ndaj nëpunësit autorizues. *Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.*

Nga kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit, rezulton se gjatë vitit 2021 janë likujduar 13 raste në shumën 47,969,662 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2018, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2021 për tu likujduar. Janë likujduar 33 raste në shumën 77,035,471 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2019, ndërkohë që janë regjistruar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021 dhe 54 raste në shumën 53,179,933 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2020, ndërkohë që janë regjistruar për tu paguar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021.

Gjithashtu referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezulton të ketë fatura të vitit 2021 të cilat janë regjistruar dhe likujduar në sistem në vitin 2022, fatura të cilat i përkasin shpenzimeve apo detyrimeve të vitit 2021 në shumën 7,581,104 lekë.

Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. *Veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61, nenin 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1, nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Projektraportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësisë të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

3.2. Rekomandimi: Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për paraqitjen në kohë me besueshmëri të shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare me qëllim, raportim të drejtë të situatës financiare të Njesisë.

Brenda datës 31.12.2022

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2021 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër

kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajtje kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2022

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 në lidhje me zërin (Tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. *Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11 dhe neni 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Brenda datës 31.12.2022

V. ANEKSE

Anekset janë pjesë përbërëse e këtij Raport Auditimi:

Aneksi nr. 2. Faturat e pa regjistruara në sistemin SIFQ në 2021, Bashkia Roskovec.

Nr. Fat.	Kodi Projektit	Përshkrimi i projektit	Furnitori	Shuma fat. lekë	Dt. Faturës	Dt. Regjistrimit
93	1130188	Sistemimi asfaltim rrugës fshati Velmish	B....	4,000,000	17.12.2021	19.04.2022
11	1130341	Kolaudim: Gjymnazi Adem Vrapit	E.K.	45,800	04.11.2021	05.05.2022
13	1130341	Kolaudim - Perforcim Banesa Ekzistuese	E.K.	20,900	04.11.2021	05.05.2022
14	1130341	Kolaudim punimesh lagja çervënë	E.K.	9,400	04.11.2021	05.05.2022
5	1130341	Mbikqyrje punimesh per zgjerim e	S...	53,622	25.11.2021	05.05.2022

Nr.	Kodi	Përshkrimi i projektit	Furnitori	Shuma	Dt.	Dt.
		rrugës jagodine Suk-1 strum L=9.57 km				
6	1130341	Mbikqyrje punimesh per rikonstruksionrrugësh lagja fushe fshati kurjan 714 ml	S...	39,240	25.11.2021	05.05.2022
7	1130341	Mbikqyrje punimesh per rikonstruksion I rrugës se kooperativës Roskovec360 ml	S...	58,680	25.11.2021	05.05.2022
8	1130341	Mbikqyrje punimesh per rikonstruksion I rrugësHysni toska fshati Luar 350 ml	S...	21,060	25.11.2021	05.05.2022
11	1130341	Supervizion te objekteve ne procedure te natyrës se ngjashme Rikualifikime urbane sipas kontratës se shërbimit nr.1334 date 20.03.2019	S...	336,000	25.11.2021	05.05.2022
389	1130287	Pyllëzime	A.....	296,400	06.12.2021	05.05.2022
10	1130341	Mbikqyrje Punimesh: Rikonstruksion I rrugësrrerth rrotullimi Vajza Myzeqare Roskovec-Marinez	G....	337,896	20.11.2021	05.05.2022
13	1130341	Mbikqyrje Punimesh: Rikonstruksion I rrugësrrerth rrotullimi Vajza Myzeqare Roskovec-Marinez	G....	109,440	20.11.2021	05.05.2022
12	1130341	Mbikqyrje Punimesh: Rikonstruksion I rrugësrrerth rrotullimi Vajza Myzeqare Roskovec-Marinez PO-P245	G....	89,258	20.11.2021	05.05.2022
63	9999999	Riparime te pjesshme ne shkolla ne administrim te Bashkise	D...	2,163,408	09.11.2021	05.05.2022
		SHUMA :		7,581,104		

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

